

L I G J
Nr.8158, datë 7.11.1996

**PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR. 1631, DATË 1.11.1996 "PËR DISA
NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7926, DATË 20.4.1995 "PËR TRANSFORMIMIN E
NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE"', NDRYSHUAR ME
DEKRETIN NR.1195, DATË 14.8.1995 DHE LIGJIN NR.8099, DATË 28.3.1996**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet me ndryshime dekreti nr.1631, datë 1.11.1996 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me dekretin nr.1195, datë 14.8.1995 dhe ligjin nr.8099, datë 28.3.1996 si vijon:

1. Neni 1 i dekretit riformulohet: "Neni 4 i ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" ndryshohet si më poshtë:

Ministria e Privatizimit është përfaqësuese e pronarit për pronën shtetërore.

Ministria e Privatizimeve kryen transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare dhe privatizimin e tyre; drejton punën për hartimin e akteve të themelimit të shoqërive që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve, nënshkruan kapitalin themeltar dhe autorizon regjistrimin e tyre.

Ministritë, departamentet, drejtoritë apo institucionet e tjera që varen drejtpërdrejt nga Këshilli i Ministrave, si dhe organet përkatëse të pushtetit lokal përgjigjen për administrimin e pronës shtetërore që kanë në varësi.

Prona shtetërore në shoqëritë me kapital të përbashkët administrohet nga organi që ka bërë nënshkrimin e pjesës shtetërore të kapitalit ose, kur kjo gjë nuk është kryer, administrohet nga dikasteri ose organi i pushtetit lokal që ka nënshkruar kontratën. Transferimi i së drejtës së ortakut shtetëror në këto shoqëri (si kapitali i pjesës shtetërore etj.) bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave."

2. Neni 3 i dekretit riformulohet:

"Neni 6 i ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" shfuqizohet."

3. Paragrafi i dytë i nenit 4 të dekretit të riformulohet: "Ministri i Privatizimeve ka të drejtë të marrë masa disiplinore deri në largimin nga detyra për çdo drejtues të ndërmarrjes shtetërore, i cili ka penguar procesin e privatizimit."

4. Në nenin 5 të dekretit, paragrafi i dytë, fjalia e dytë të riformulohet: "Një e treta e anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrëse emërohen nga Ministria e Privatizimeve dhe dy të tretat nga ministritë, departamentet, drejtoritë apo institucionet e tjera që varen drejtpërdrejt nga Këshilli i Ministrave, si dhe organet përkatëse të pushtetit lokal. Për Këshillat Mbikëqyrës ekzistues, Ministria e Privatizimit zgjedh një të tretën e të emëruarve të saj nga anëtarët ekzistues, kurse pjesa që mbetet i kalon ministrisë, departamentit, drejtorisë, apo institucioneve të tjera që varen drejtpërdrejt nga Këshilli i Ministrave, si dhe organet përkatëse të pushtetit lokal."

5. Paragrafi i fundit i nenit 5 të dekretit del nën më vete me numër 5.1.

6. Pas nenit 6 shtohet neni 6/a me këtë përmbajtje:

"Prona shtetërore që ka filluar procesin e privatizimit para hyrjes në fuqi të këtij dekreti vazhdon privatizimin pa ripërsëritur etapat e privatizimit që i ka kryer sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në atë kohë.

Për shoqëritë tregtare të regjistruara në gjykatë në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", përfaqësues i pronarit për aksionet dhe pjesët e kapitalit shtetëror do të jetë

Ministria e Privatizimeve, sipas përcaktimit të nenit 1.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1641, datë 19.11.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha